



## **VENDIM I PAPRANUESHMËRISË**

**Data e miratimit: 5 shkurt 2014**

**Numri i lëndës: 2013-17**

**Ramadan Rahmani**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 shkurt 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 24 qershor 2013.

## II. FAKTET

2. Siç janë parashtruar nga ankuesi, faktet e lëndës mund të përmbliidhen si më poshtë:
3. Ankuesi pohon se më 14 shtator 1977 ishte lënduar në vendin e punës së tij në ndërmarrjen shtetërore (NSH) "Ramiz Sadiku".
4. Ankuesi thekson se lidhur me lëndën e tij ishin marrë disa vendime, duke vërtetuar se ai kishte të drejtë në marrjen e pensionit invalidor. Përveç pensionit, atij iu ishte njohur e drejta në kompensimin e pagës, që do ta kompensonte pagën e tij deri në moshën 65 vjeçare.
5. Ankuesi iu drejtohet "vendimeve" të marra nga ish punëdhënësi i tij NSH "Ramiz Sadiku" më 13 maj 1989, një vendimi nga Gjykata e Punës së Bashkuar në Prishtinë të datës 17 mars 1986, një vendimi nga Gjykata Themelore e Prishtinës e datës 17 mars 1987 dhe një vendimi nga Gjykata Supreme e Kosovës e datës 21 prill 1993.
6. Ankuesi pohon se të gjitha këto vendime kanë vërtetuar se kishte të drejtë që të merr pensionin invalidor dhe të drejtën për kompensimin e pagës. Ai i ka gëzuar këto të drejta deri në vitin 1999. Pas kësaj, ai edhe më tutje merrte pensionin invalidor, mirëpo jo më kompensimin e pagës.
7. Ankuesi pohon se ka paraqitur ankesa në disa organe. Më 19 mars 2013, Gjykata Kushtetuese ka marrë një "Vendim mbi papranueshmëri", ku ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit, pasi ajo ishte parashtruar "jashtë afatit".
8. Më 10 qershor 2011, Trupi Gjykses i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS) ka marrë vendim rreth kësaj çështje dhe ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit si të pabazuar.
9. Më 15 gusht 2011, ankuesi dhe 117 ankues të tjera kanë parashtruar një ankesë kundër aktgjykimit të Trupit Gjykses të DhPGjS në Panelin për ankesa të DhPGjS. Ankuesi ka kërkuar që ta pranojnë ankesën e tij, që ta përfshijnë atë në listën e punëtorëve që kanë të drejtë në pjesën e 20% të të ardhurave prej privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku", si dhe të anulohet aktgjykimi i kontestuar.
10. Më 22 prill 2013, Paneli i ankesave të DhPGjS-së e ka vendosur se lënda është e pranueshme, mirëpo e pabazuar. DhPGjS-ja ka konstatuar se ankuesi si dhe disa ankues të tjerë nuk kishin parashtruar dëshmi për të dëshmuar se ata ishin të diskriminuar në çfarë mënyre të veçantë "dhe se ata [as nuk kishin pretenduar] ndonjë fakt nga i cili mund të supozohet se ka [pasur] diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë". Sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me të drejtat e tij për pension, Paneli i ankesave të DhPGjS-së e ka refuzuar kërkesën e tij si të pabazuar, megjithatë pa siguruar ndonjë arsyetim.

11. Ankuesi pohon se Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese kanë mohuar "të drejtën e tij themelore si person me aftësi të kufizuara për kompensimin e pagës [së tij]".
12. Më tutje, ankuesi ka pohuar se nuk ishte kompensuar në mënyrë siç duhej në lidhje me privatizimin e NSH "Ramiz Sadiku".

### III. ANKESAT

13. Në thelb, ankuesi kërkon që lënda e tij të shqyrtohet edhe një herë nga gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it. Ai kërkon kompensimin e pjesën së 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", si dhe kompensimin e pagës, përveç pensionit të tij invalidor.

### IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në konceptin e llogaridhënies së EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të jenë të garantuara nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, policisë dhe doganë.
17. Paneli në disa raste ka konstatuar sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, se nuk ka kompetencë as mbi fushën administrative e as mbi fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, apo ulen në trupin gjykues të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nuk ia humb atyre gjykatave karakterin e të qenurit pjesë e gjyqësorit të Kosovës (ndër të tjera shih nr. *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013 në par. 25; *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 në par. 31 apo *Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013 në par. 21).
18. Prandaj, çështjet që kanë të bëjnë me këtë lëndë nuk bien në kuadër të mandatit të Panelit siç saktësohet në rregullën 25, par. 1 të rregullore së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se ankesa bie jashtë kompetencave të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

**SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese